

Raport

Donatorët në mbështetje të shoqërisë civile

STRATEGJITË DHE PRAKTIKAT



 Queen Mary
University of London



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

© 2014 Balkan Civil Society Development Network and the Queen Mary
University of London

Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN)

Adresa: Mitropolit Teodosij Gologanov 39/II-2, 1000 Shkup, Maqedoni

E-mail: executiveoffice@balkancsd.net

Website: www.balkancsd.net | www.monitoringmatrix.net

Redaktore: Tanja Hafner Ademi

Autorë: Mladen Ostojic, Prof. Dr. Adam Fagan

Përkthimi në shqip: IDM Albania

Foto në ballinë: Ken Teegardin (CC-BY)



në partneritet me



Donatorët në mbështetje të shoqërisë civile: Strategjitë dhe praktikat

Rasti i Shqipërisë



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Parathënie

Raporti “Strategjitë dhe praktikat e donatorëve në mbështetje të shoqërisë civile në Ballkanin perëndimor” është hartuar nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) në bashkëpunim me Universitetin Queen Mary të Londrës në vitin 2014.

Ky raport paraqet një vështrim të përgjithshëm të qasjes së donatorëve ndaj shoqërisë civile në Ballkanin perëndimor, arsyet e pranisë së tyre, mekanizmat e përdorur në mbështetje të sektorit të tretë së bashku me perceptimet e donatorëve mbi vlerën e shoqërisë civile. Nga ana metodologjike, raporti bazohet në 84 intervista gjysmë të strukturuar të zhvilluara me donatorë kyç në rajon dhe në studimin sasior të kryer në 2011, i cili identifikonte donatorët kryesorë dhe qasjen e zbatuar.

Ai mbulon periudhën shtator 2013 – shkurt 2014.

Raporti përmban dhe një pamje të përgjithshme të ndihmës për shoqërinë civile së bashku me modalitetet e planifikimit dhe mënyrat e programimit, sipas vendeve specifike të rajonit – nga ku është përkthyer dhe ky dokument për Shqipërinë.

Niveli i mbështetjes

Një numër relativisht i kufizuar donatorësh mbështet shoqërinë civile në Shqipëri. Bashkimi Evropian (BE) është donatori më i rëndësishëm me një buxhet vjetor prej rreth 93.2 milionë euro, nga ku 1.5 milionë euro rezervohen për "Projektin për Shoqërinë Civile - CSF".¹ Në të ardhmen, buxheti i CSF-së mund të arrijë në 2 ose 2.5 milionë euro. Ndërkaq OShC-të shqiptare mund të përfitojnë dhe nga "Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut- EIDHR"² dhe "Programi për Bashkëpunimin Ndërkufitar - CBC".³ Donatori i dytë më i rëndësishëm është Gjermania me 31.5 milionë euro të alokuara në periudhën 2012-2014. Megjithatë, pjesa më e madhe e ndihmës gjermane përfshin dhënien e kredive dhe nuk ka si përfitues të drejtpërdrejtë shoqërinë civile. Ndërkohë, Zvicra është e përfshirë në Shqipëri në termat e bashkëpunimit për zhvillim. Zyra e Bashkëpunimit Zvicëran (SDC) mbështet shoqërinë civile në kuadër të programit të saj mbi demokratizimin dhe qeverisjen vendore me një buxhet prej 25 milion CHF (rreth 20.7 milionë euro) dhe programit të shëndetit me një buxhet prej 10 milionë CHF (rreth 8.3 milionë euro). Ambasada e Suedisë mbetet një mbështetëse e rëndësishme, e cila e zbaton ndihmën për shoqërinë civile përmes organizatave suedeze: Kvinna till Kvinna, Qendra Olof Palme dhe Civil Rights Defenders (me buxhete tre-vjeçare prej 14, 15 dhe 16 milionë SEK, përkatësisht - rreth 1.5, 1.6, 1.7 milionë euro). SIDA gjithashtu mbështet OShC-të mjedisore me një buxhet prej 15 milionë SEK për tre vjet (rreth 1.6 milionë euro) përmes Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC). Ambasada holandeze zbaton Programin MATRA, buxheti i të cilit është 350.000 euro, ndërsa Ambasada Amerikane administron Programin e Granteve të Vogla të Komisionit për Demokracinë⁴ me një buxhet vjetor prej 500,000 USD (rreth 395,000 euro). Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (OSFA) ka një program për shoqërinë civile, buxheti i të cilit është rreth 150.000 USD (ose rreth 118,000 euro) në vit.

Një pjesë e donatorëve shprehen se buxhetet e tyre kanë ardhur duke u zvogëluar përgjatë viteve të fundit. Madje, mund të thuhet se ka edhe dëshmi të një "fluturimi të donatorëve" nga Shqipëria. I intervistuari nga USAID-i, konstaton se fondet janë ulur me rreth dy të tretat përgjatë një dekade (nga rreth 30 milionë USD në vitin 2002, në 10 milionë USD në 2012). Ndërkohë, i intervistuari nga zyra e SIDA-s shprehet se "nuk është më i njëjti mjedis për donatorët si 5-6 vjet më parë dhe kjo vihet re veçanërisht për

¹ Civil Society Facility.

² European Instrument for Democracy and Human Rights.

³ Cross Border Cooperation.

⁴ Democracy Commission Small Grants Programme.

grupin e donatorëve të shoqërisë civile; përveç BE-së nuk ka më donatorë të mëdhenj në këtë grup; organizatat ndërkombëtare si OSBE, PNUD, Zvicëranët nuk ofrojnë më të njëjtën mbështetje si më parë; por ky mbetet gjithmonë perceptimi im".

Arsyet për praninë e donatorëve

Shteti i së drejtës⁵ dhe qeverisja e mirë⁶ mbeten prioritetet kryesore e donatorëve në Shqipëri. Megjithatë, objektivi i tyre afat-gjatë është Integrimi Evropian.⁷ Sipas një zyrtari të USAID-it "synimi numër një është mbështetja për integrimin evropian dhe kjo përbën sfidën numër një të Shqipërisë". Nga perspektiva e BE-së, sipas të intervistuarit nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri "objektivi i çdo euro-je të harxhuar është mbështetja për anëtarësim."

Planet për të ardhmen

Perspektiva e integritit të Shqipërisë në BE formëson planet e donatorëve për të ardhmen. Një i intervistuar nga USAID-i citoi shembujt e vendeve të CEE-së (Evropa Qendrore dhe Lindore) dhe SEE-së (Evropa Jug-lindore) të anëtarësuar në BE në 2004 dhe 2007 për të treguar se do të ketë më shumë fonde nga BE-ja ndërsa Shqipëria i afrohet anëtarësimit. Zyrrat e USAID-it në Bullgari dhe Rumani u mbyllën në 2008 në vijim të anëtarësimit të këtyre vendeve në BE, megjithatë, sipas USAID-it, "për momentin nuk ka pasur diskutime në lidhje me strategjitë e largimit nga Shqipëria". Ky angazhim afat-gjatë konstatohet edhe nga donatorë të tjerë. Edhe pse në krahasim me skenarin e propozuar nga USAID-i, i intervistuari nga OSFA u shpreh se anëtarësimi i Shqipërisë në BE nuk do të shpjerë në një largim të menjëhershëm nga vendi. Për shembull, zyrrat e Shoqërisë së Hapur në Sllovakia u mbyllën në vitin 2013, edhe pse vendi u anëtarësua në BE-në rreth një dekade më parë. Megjithatë, i intervistuari vuri në dukje se "nivelet e ndihmës nuk do të rriten për shkak të kapaciteteve të dobëta përthithëse të organizatave shqiptare."

⁵ Siç u identifikua nga Ambasada e Holandës, pas 2011, nga OSFA dhe USAID.

⁶ Siç u identifikua nga OSFA, SDC dhe USAID.

⁷ Siç u identifikua qartasi nga OSFA, SDC dhe USAID.

Modalitetet e planifikimit dhe programimit të donatorëve

Qeveria shqiptare përfshihet në planifikimin dhe programimin e aktiviteteve të pjesës më të madhe të donatorëve ndërkombëtare aktivë në Shqipëri. Kjo qasje mbizotëruese nga lart-poshtë për hartimin e strategjive u artikulua nga i intervistuari i Ambasadës Gjermane: "ideja e bashkëpunimit financiar përfshin qeverinë që bashkëpunon me një qeveri tjetër; në konsultimet tona vjetore qeveritare ne dakordësohemi me qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike se cilat projekte do të ndjekim." Për disa donator kjo realizohet qartësisht me anë të marrëveshjeve dypalëshe midis qeverive të huaja dhe asaj shqiptare (p.sh. aktiviteteve të donatorëve zviceranë, suedezë, dhe amerikanë në Shqipëri). Ndërkohë, identifikimi i prioriteteve dhe projekteve të Bankës Botërore aprovohet me një akt të parlamentit (si rrjedhojë zyra e Bankës Botërore ruan kontakte të ngushta me komisionet parlamentare relevante).

Një përjasje sektoriale për zhvillimin e strategjive të ndihmës ndiqet nga donatorët e huaj dhe autoritetet shqiptare. Kështu, OSFA mban një sërë takimesh me pjesë të caktuara të politikave të qeverisë shqiptare. USAID-i dhe donatorë të tjerë promovojnë marrëdhënie të mira me qeverinë shqiptare sipas sektorëve. Për shembull, ekziston një bashkëpunim veçanërisht i mirë mes USAID-it dhe Ministrisë së Drejtësisë për çështjen e shtetit të së drejtës; gjithashtu, mes SIDA-s dhe autoriteteve tatimore, Institutit të Statistikave dhe Ministrisë së Mjedisit.

Shumë të intervistuar përmendën përfshirjen e tyre në Grupet sektoriale të Punës (GP) të donatorëve që koordinohen nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (DEBASKON) dhe në të cilat marrin pjesë donatorët ndërkombëtarë dhe ministritë përkatëse. Ambasada holandeze është përfshirë në GP-në e organizuar nga Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore për të shkëmbyer informacione dhe për të koordinuar strategjitë antikorrupsion. SIDA është aktive në GP-të gjinore dhe të shoqërisë civile, ndërsa Zviceranët janë donatorët lider në fushat e decentralizimi, zhvillimi rajonal, dhe formimit profesional. Megjithatë i intervistuari nga SDC tregon se ka variacion të konsiderueshëm përsa lidhet me efektivitetin e GP-ve, në varësi të Ministrisë udhëheqëse; një vëzhgim të cilin e konstatoi dhe i intervistuari nga USAID-i. I intervistuari nga SIDA theksoi se informacioni rreth aktiviteteve të donatorëve mund të gjendet në faqen e internetit të DEBASKON-it, i cili së bashku me Sekretariatit Teknik të Donatorëve (STD), ka hartuar një bazë të përditësuar të dhënash rreth aktiviteteve të donatorëve në vend.

Ndërkohë, disa donatorë ndërkombëtarë angazhojnë edhe aktorët në nivele më të ulëta të qeverisjes në procesin e programimit të ndihmave. Zyra e Bashkëpunimit Zvicëran zhvillon konsulta me qeverisjen vendore, ndërsa OSFA përfshin autoritetet bashkiake duke bërë bashkë organizatat e shoqërisë civile lokale dhe zyrtarët në bashki për të formuar 'plane të veprimit vendor' që llobojnë për financim lokal bazuar në prioritetet e identifikuar. Qeverisja vendore është përfshirë edhe në formën e nën-kontraktimit të implementuar nga Ambasada Holandeze. Në Dibër, fondet iu dhanë qeverisjes vendore për të vendosur prioritetet dhe organizuar thirrjet për propozime. Nga ana tjetër, në çështjet gjinore, OSFA punon me Grupet Lokale të Veprimit (LAGs), të cilat mbulojnë më shumë se një njësi të qeverisjes vendore në zonat rurale dhe koordinohen nga qeveria, shoqëria civile dhe sektori privat. LAGs u ngritën në Shqipëri nga Oxfam dhe SNV.

Edhe pse këto janë qasje "lart-poshtë" të identifikimit të prioritetëve në programet e ndihmës, ka edhe disa qasje "poshtë-lart" në të cilat donatorët ndërkombëtarë përfshijnë aktorët vendorë. BE kur programon "Projektin për Shoqërinë Civile" (CSF), në mënyrë eksplicite anashkalon qeverinë. Ndërkohë, OSFA identifikon prioritetet e shoqërisë civile përmes konsultimeve formale dhe joformale me OShC-të lokale. Më tej, drafti i hartuar shkon në Bordin Ekzekutiv të Fondacionit, ku shqyrtohet para finalizimit të dokumentit të programit. Edhe pse programimi i SIDA-s caktohet nga Ministria e Punëve të Jashtme në Stokholm, sipas një zyrtari të SIDA-s në Tiranë, identifikimi i prioritetëve "fillon me konsultime me partnerët tanë të shoqërisë civile, p.sh. çfarë mendojnë ata se janë problemet, a jemi ne duke bërë gjërat e duhura, çfarë duhet bërë, cilat janë përshtypjet..."

Megjithatë, prioritizimi brenda programeve të ndihmave formulohet nga aktorë që nuk e kanë bazën në Shqipëri. Siç u përmend më lart, ndihma e SIDA-s zbatohet përmes nën-kontraktimit nga tre organizata kornizë suedeze, të cilat nga ana tjetër kanë përgjegjësi për programimin: Qendra Palme, Kvinna til Kvinna, dhe Civil Rights Defenders. Në mënyrë të ngjashme, Ambasada Holandeze mbështetet në organizatën holandeze SNV, duke qënë se SNV ka 18 vjet në rajon dhe përbën një "garanci".

Ndërkohë, për shumë nga donatorët dypalësh aktivë në Shqipëri, vendimet në lidhje me programimin merren përfundimisht në 'vendin e tyre të origjinës'. Ambasada holandeze jep mendime rreth programimit, por vendimi përfundimtar merret në Hagë - i tillë si prioritizimi i shtetit të së drejtës në strategjitë e tyre. Strategjitë e Zyrës së Bashkëpunimit Zvicëran dakordësohen nga një akt i parlamentit në Zvicër. Për Ambasadën Amerikane, Uashingtoni analizon procesin e miratimit teknik, edhe pse në pjesën më të madhe të rasteve ajo që është miratuar nga Komisioni për

Demokraci miratohet dhe në Uashington. Prioritetet e USAID-it miratohen nga Kongresi i SHBA-së, por ç'është më e rëndësishmja, ka fleksibilitet për të ndryshuar strategjitë sipas nevojave. Ndërsa për SIDA-n, programimi përcaktohet më shumë në Suedi sesa në terren. Prej 2015, pritet që vendimet të merren në zyrat lokale dhe nuk do të ketë më nevojë të konsultohet selia kryesore e SIDA-s, edhe pse do të kërkohet miratimi i saj për projektet e mëdha.

Rëndësia e kryerjes së hulumtimeve ose monitorimit si pjesë e procesit të programimit u theksua gjithashtu nga disa donatorë. OSFA kryen shqyrtime literature para se të konsultojë aktorët e interesit, kështu që organizata punon "edhe si një think-tank në çështje të ndryshme që janë të rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë. Pra, ky është një funksion i dyfishtë i organizatës; ne [OSFA] jemi donatorë dhe zbatues". Për BE-në, monitorimi i sektorit Politik, Ekonomik dhe i Informacionit i Delegacionit, është baza për Raportet e Progresit dhe seksionin e Operacioneve (që zbatojnë mbështetjen e BE-së). Raportet e Progresit janë vendimtare për formulimin e programeve.

Koordinimi mes donatorëve

Edhe pse strukturat e koordinimit të donatorëve në formën e GP-ve të DEBASKON-it (të përshkruara në seksionin e mëparshëm) kërkojnë udhëheqje nga ana e qeverisë shqiptare, të intervistuarit shprehën shqetësimin e tyre në lidhje me kapacitetet e qeverisë së re në Tiranë. Për shembull, i intervistuari i Shoqërisë së Hapur u shpreh se: "Mua nuk më bën shumë përshtypje ky lloj koordinimi; në këtë kohë ka shumë pak koordinim – për shkak se qeveria ka dy muaj në detyrë. Si rrjedhojë, nuk është shumë e qartë se si do të menaxhohet situata; ekziston një lloj konfuzioni se kush është duke bërë çfarë në këtë moment." Si rrjedhojë e këtij koordinimi të dobët, ka raste të koordinimit ad hoc mes donatorëve në Shqipëri. Ambasada gjermane, për shembull, mori pjesë në një takim jozyrtar drekte me donatorët e tjerë (ditën e intervistës) për të diskutuar mbi koordinimin rreth sektorit të ujit. Ky takim u organizua për shkak të kapaciteteve të ulëta të qeverisë shqiptare – pasi ministria përkatëse nuk mund të menaxhonte 20 donatorë në të njëjtën kohë. Para ngritjes së GP-ve sektoriale, donatorët takoheshin midis tyre, por edhe pse partnerët shqiptarë ishin të ftuar ata nuk merrnin pjesë. Ambasada holandeze ka qenë pjesëmarrëse në takime të organizuara nga vetë donatorët për koordinimin e aktiviteteve lidhur me reformën e burgjeve dhe shoqërinë civile. OSFA ka nënvizuar kontaktin joformal me Delegacionin e BE-së në Tiranë: "Ne shkëmbejmë informacione midis nesh dhe gjithashtu me Delegacionin; kjo bazohet më shumë në vullnetin tonë se

sa në ndonjë mekanizëm për t'u bashkuar dhe diskutuar". I intervistuari nga Ambasada Amerikane foli për Komisionin për Demokraci i cili është një organ konsultativ që përfshin përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe zyrtarë nga donatorë të tjerë në Shqipëri: "[Ne] përqipemi të diskutojmë mbi të gjitha propozimet që ne [Ambasada Amerikane] kemi marrë; nëse ka projekte të ngjashme që janë mbështetur në të shkuarën, duke marrë gjithashtu informacion mbi organizatat dhe informacion për bashkë-financimin. Në qoftë se ne nuk jemi në gjendje për të financuar disa nga propozimet, donatorët e tjerë mund të ndihmojnë." Ky koordinim siguron se nuk do të ketë një mbivendosje të aktiviteteve të donatorëve. I intervistuari nga Ambasada Gjermane përmendi shembullin e rishpërndarjes së TVSH-së si një shembull ku ka pasur koordinim të mirë midis donatorëve. Ndërkohë, një model që u sugjerua nga një i intervistuar i Bankës Botërore për të shmangur konfuzionin mes donatorëve është krijimi i një "sistemi vendor" nëpërmjet të cilit procedurat për ndihmë (p.sh. prokurimi dhe menaxhimi financiar) të jenë të standardizuara duke lehtësuar donatorët dhe qeverinë.

Ndërveprimi midis donatorëve në Shqipëri ka çuar në disa shembuj praktikash të mira. Për shembull, i intervistuari nga Ambasada Gjermane tha se "secili donator sjell diçka nga institucionet e tij shkencore, nga vendet e tyre ose nga bashkëpunimi me një institucion shqiptar dhe kjo gjithashtu ndikon në strategjitë tona." Sipas të intervistuarit të SIDA-s, qasja e SIDA-s për zhvillimin e shoqërisë civile është pritur pozitivisht dhe nga BE-ja.

Disa donatorë janë përcaktuesit e rendit të ditës në sektorë të veçantë. Për shembull, në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile, Delegacioni e sheh veten si donatori që ka marrë iniciativën për të koordinuar mbështetjen e shoqërisë civile; fakt i cili konfirmohet dhe nga SIDA: "Ka pasur një... prezantim nga Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit për mbështetjen e shoqërisë civile, i cili ishte shumë i dobishëm sidomos për ne që jemi në procesin e bërjes operacionale të strategjisë tonë; kështu që shumëçka do të ndodhë me programet tona aktuale për shoqërinë civile duhet të ndjekë dhe plotësojë mbështetjen e BE-së." Përfaqësuesi i zyrës së TACSOs tha se edhe pse GP-të për shoqërinë civile kanë filluar me një nismë të OSBE-së me një udhëheqje të rradhës është e qartë se ndihma e BE-së është ajo që mbizotëron. "BE-ja është duke përdorur projektet tona si sekretariat teknik, duke mbajtur të dhëna për mbështetjen financiare, që shumëkush të jetë në gjendje për të parë mbështetjen e tyre ose ta krahasojë atë me mbështetjen e organizatave të tjera". I intervistuari nga Ambasada Gjermane shtoi se donatori 'lider' varet nga sektori. Në sektorin e ujit, Gjermania dhe Banka Botërore janë aktive. Për shembull, Gjermania (përfshirë GIZ dhe KfW) ka një staf prej 110 personash në Shqipëri, kështu që ka kapacitet për të shkruar dokumente strategjike dhe për të patur më shumë ndikim. Suedia është e fortë në

arsimin profesional dhe qeverisjen e mirë. Banka Botërore, BE-ja, dhe OSBE janë të fortë në sektorët e tjerë, ndërkohë që edhe austriakët kanë ndikim gjithashtu.

Një aspekt i modelit të SIDA-s për zhvillimin e programeve të ndihmës që nuk u përmend nga të intervistuarit e tjerë ishte koordinimi ndër-donator, d.m.th shkëmbimi dhe konsultimi midis zyrave të ndryshme në rajon. Për donatorët që nuk kanë një model të tillë, ky model mund të jetë i dobishëm për ta zhvilluar këtë lloj shkëmbimi. Sipas të intervistuarit nga SIDA: “ne kemi pasur GP-të nga vendet e rajonit që punonin në të njëjtën fushë - shoqëri civile, çështje gjinore, të drejtat e njeriut, të ulur së bashku... me analizat e tyre kontekstuale, me vlerësimet e tyre, raportet...”

Ndihma e donatorëve për shoqërinë civile

Ndhimja e donatorëve për shoqërinë civile në Shqipëri ofrohet përmes granteve të drejtpërdrejta, partnerëve zbatues ose formave jo-financiare të mbështetjes. Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri mbështet shoqërinë civile përmes programeve CSF dhe EIDHR, por edhe përmes programit CBC, ku 100 kontrata me vlerë 28 milionë euro janë nënshkruar në pesë vitet e fundit. Edhe pse CBC është projektuar për të mbështetur njësitë e qeverisjes vendore në zonat kufitare, ajo është gjithashtu e hapur për OShC-të - të cilat në fakt përfaqësojnë përfituesit kryesorë të fondeve nga ky program. Sipas përfaqësuesit të zyrës së TACSO-s në Tiranë, 80% e fondeve të CBC-së kanalizohen përmes OShC-ve. OShC-të shqiptare gjithashtu përmbushin kriteret për “Rinia në Veprim” (Youth in action) dhe “Kultura dhe Evropa për Qytetarët” (Culture and Europe for citizens) që administrohen nga qeveria shqiptare. Delegacioni i BE-së në Shqipëri kërkon të vëjë theksin në mbështetjen e organizatave të vogla duke i inkurajuar për të hyrë në partneritet me OShC-të e përforcuara kur aplikojnë për fondet e BE-së. Pjesa më e madhe e përfituesve të programit CBC janë organizata më të vogla e periferike.

Përveç BE-së, disa donatorë të tjerë ofrojnë grante të drejtpërdrejta për shoqërinë civile. Edhe pse nuk ka një program specifik për shoqërinë civile, USAID-i mbështet OShC-të përmes programeve të shtetit të së drejtës, qeverisjes së mirë dhe konkurrueshmërisë. Grantet e USAID-it variojnë nga 7,000 USD në 2.5 milionë USD dhe zgjasin deri në tre vjet. Në Shqipëri, USAID-i ka zgjedhur të punojë direkt me OShC-të lokale për t'i ndihmuar të ndërtojnë kapacitetet dhe për të shmangur kostot shtesë që lidhen me ndërmjetësit ndërkombëtarë. Përveç kësaj, Ambasada Amerikane

administron dhe Programin e Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci, ku OSHC-të lokale mund të aplikojnë. Zyra e Bashkëpunimit Zviceran gjithashtu ka një Small Action Fund (Fond i Veprimit të Vogël) për OShC-të me një buxhet vjetor prej 200,000 CHF (rreth 166,000 euro), ndërsa Ambasada holandeze mbështet OShC-të përmes programit MATRA duke u fokusuar në shtetin e së drejtës dhe integrimin në BE. OSFA, e cila dikur ofronte fonde për zhvillimin institucional të OShC-ve, tani mbështet shoqërinë civile vetëm përmes granteve të projekteve. Banka Botërore mbylli Fondin e Shoqërisë Civile në vitin 2012, por ende ka një program të vogël me një buxhet prej 50.000 USD (rreth 39,000 euro) që fokusohet në fuqizimin e grupeve vulnerabël.

Ndërkohë, një numër donatorësh mbështetet tek partnerët zbatues për ofrimin e ndihmës ndaj shoqërisë civile për të minimizuar rrezikun e keqpërdorimit të fondeve dhe korrupsionit. Ambasada Holandeze e kanalizon asistencën e saj për organizatat mjedisore përmes Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) në mënyrë që të arrijë organizata më të vogla që veprojnë jashtë Tiranës. REC gjithashtu administron grante për OShC-të mjedisore në emër të SIDA-s. Kjo praktikë pritet të ndryshojë pasi kontrata e SIDA-së me organizatat kornizë suedeze të angazhuara në ndërtimin e kapaciteteve të OSHC-ve shqiptare përfundoi në 2014. BE-ja mbështet organizatat që merren me të drejtat e fëmijëve nëpërmjet UNICEF-it dhe ato që lidhen me komunitetin rom dhe egjiptian përmes PNUD-it.

Së fundmi, disa donatorë deklarojnë se ofrojnë në mënyra të ndryshme dhe mbështetje jo-financiare për shoqërinë civile. Për shembull, zyrtarët e OSFA-s deklarojnë se ndihma e fundit nuk ka qenë në formën e granteve të drejtpërdrejta të projekteve, por në formën e mbështetjes për organizimin e protestave dhe takimeve për çështjet mjedisore. Përveç granteve, BE-ja ofron dhe asistencë teknike përmes TACSO-s, ndërsa programi “Njerëzit-tek-Njerëzit” (People to People) u jep mundësinë përfaqësuesve të OShC-ve nga të gjitha vendet e Ballkanit përëndimor të shkojnë në Bruksel për t’u takuar me përfaqësues të BE-së dhe për t’u trajnuar në një subjekt të caktuar. USAID-i gjithashtu ofron asistencë teknike në ndihmë OShC-të në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve organizative dhe qeverisjes së brendshme.



Raportin e plotë në gjuhën angleze mund ta gjeni tek:

<http://www.balkancsd.net/>



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Ky studim është prodhuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe BTD. Përmbajtja e këtij studimi është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e BE-së ose BTD-së.